



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “International Security Association shpk” të datës 26.05.2025 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me nr. të prokurimit 616-25-10100-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “International Security Association shpk” të datës 26.05.2025 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me nr. të prokurimit 616-25-10100-2-1-1.
- II. AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “International Security Association shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 26.05.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 21.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me nr. të prokurimit 616-25-10100-2-1-1.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "OE Besa Security ne oferten e tyre jane te skaduara Autorizimi per perdorim te frekuencave I cili ka qene I skaduar para hapjes se tenderit gjeni te bashkengjitur me kerkesen per rishqyrtim autorizimin, dhe kjo ne kushtet normale do te kishte rezultuar ne eliminim te secilit OE I cili ka te skaduar nonje dokument ne oferten e tij dhe nu I eshte kerkuar sqarim ne lidhje me dokumentin per te deshmuar nese ka vazhduar apo jo autorizimin para hapjes se tenderit. Poashtu ky OE e ka te skaduar autorizimin e licences se tubimeve pubike. 2. OE Security Code ne oferten e tij nuk e ka softuerin per menaxhimin e rojeve kerkesa kjo e cila ka qene e kerkuar te bashkengjitet me oferten te ANEKS 1 specifikimet teknike te detyrueshme : 4. Me qellim te rritjes se efektivitetit te sigurisë ne objektet e veta, Autoriteti Kontraktues e konsideron si domosdoshmëri monitorimin e rojeve neper objektet e saja ne kohe reale përgjatë gjithë kohës (24/7/365). Për tu arritur kjo Autoriteti Kontraktues kërkon qe kompanitë e sigurimeve te posedojnë zgjidhje elektronike qe do te mundësonte kontrollin e rojeve ne terren ne kohe reale gjate tere kohës. Pra, se bashku me ofertën për roje fizike duhet te ofrojnë edhe propozim softuerin dhe infrastrukturën përkatëse qe i mundëson Autoritetit Kontraktues te beje monitorimin e rojeve. Sistemi i monitorimit te rojeve duhet te jete web aplikacion me qasje dhe kredenciale te kufizuara sipas politikës se Autoritetit Kontraktues. Ky sistem duhet te mundësoj regjistrimin e pikave te kontrollit ne harte digjitale, ne çdo skaj te objektit te rojës, e cila duhet te ofrohet nga ofruesi i shërbimit, ne te cilat rojet duhet te kontaktojnë përmes teknologjisë respektive. Ky sistem duhet te mundësoj pranim - dorëzimin e detyrës nëpërmjet pajisjes elektronike për kontakt ne pikat e rojës dhe duhet te këtë mundësinë e mbajtjes se procesverbaleve, te cilat duhet te përfshijnë vërejtjet eventuale ose avaritë e ndodhura me përshkrimin e gjendjes dhe fotografimin e saj. E gjithë infrastruktura për funksionalizimin e këtij sistemi, përfshirë serverët duhet te jene te ofruesit te shërbimeve. Serverët duhet te jene fizikisht ne Republikën e Kosovës dhe te dhënat e gjeneruara mbesin prone e Autoritetit Kontraktues, te cilat do te dorëzohen ne momentin e përfundimit te kontratës. Sistemi duhet te jete i sigurte dhe te mos lejoj qasje te paaautorizuara. OE duhet te ofroi përshkrimin e proceseve te punës se aplikacionit. Andaj kërkojmë na ju si AK qe te anuloni vendimin per dhenie kontrate dhe tenderin ta anuloni ne teresi duke kthyer kete AP ne piken zero, duke pas parasysh poashtu se asnje OE pjesmarres ne kete AP nuk eshte i pergjegjshem".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Për ofertën e Internat Security Association SH.P.K., ka konstatuar se vetëm formulari i tenderit është i ngarkuar ne sistemin e eprkurimit dhe te gjitha dëshmitë tjera i mungojnë. Komisioni ka kërkuar ndihmë nga KRPP përmes e-mailit zyrtar në datat: 28.02.2025, 26.03.2025 dhe 07.04.2025, për të mundësuar hapjen e ofertës. Pavarësisht kërkesave të përsëritura, zyrtari përgjegjës, z. Qendrim Berbatovci, por nuk kemi marre asnjë përgjigjeje pozitive nga KRPP, komisioni konstaton se kjo ofertë është e papërgjegjshme, pasi nuk ka pasur mundësi të verifikojë apo te shkarkoi ofertën.

Fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi parimisht nuk është fare palë e interesuar sipas nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP pasi që i njëjti ka ngarkuar vetëm formularin e tenderit dhe asnjë dëshmi dokumentare të kërkuar me DT. Pra nga asnjë këndvështrim i mundshëm parashtruesi nuk mund të argumentoj ndonjë interes material nga ky

aktivitet i prokurimit. Përndryshe fakti që parashtruesi nuk është palë e interesuar dhe ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, nuk është fakt kontestues pasi që vet parashtruesi në kërkesën e tij për rishqyrtim ka theksuar faktin që është i papërgjegjshëm ashtu që ka kërkuar që të anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit (sipas tij për mungesë të ofertave të përgjegjshme) dhe jo të kthehet në rivlerësim.

Sidoqoftë, pretendimet ankimore të parashtruesit nuk qëndrojnë pasi që tenderuesi i rekomanduar ka përmbushur të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 02.06.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.